



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64.2, nenin 82 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 13.01.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Udhëzuesit për Mënyrën e Përzgjedhjes të Personelit Teknik të Qendrave të Votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës

- I. Miratohet Udhëzuesit për mënyrën e përzgjedhjes të personelit teknik të qendrave të votimit, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 14.02.2021.
- II. Udhëzuesi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 13.01.2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Data/Datum 13.01.2021

Për/Za Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Permes/Preko Këshillit për Operacione Zgjedhore
Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së

Nga/Od Nexhmedin Hyseni, Drejtor i Departamentit të Koordinimit në Territorin
Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kopje/Kopija Zyrtarëve të Lartë Komunal të Zgjedhjeve ZLKZ / Arkivës së KQZ-së

Lënda/Predmet Udhëzues për mënyrën e përzgjedhjes së Personelit Teknik të QV-ve dhe
sigurimit të automjeteve transportuese për materialet zgjedhore për Qendra
të Votimit dhe Vendvotime për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e
Republikës së Kosovës 2021.

Afatet dhe formula e mënyrës së përzgjedhjes për Stafin Teknik të KKZ-së dhe Qendrave të Votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14 shkurt 2021 do të bëhet si në vijim:

1. ZLKZ/KKZ-të duhet të bëjnë pranimin e stafit ndihmës deri me datë 17.01.2021 Aplikacioni duhet të jetë i njëjtë sikurse aplikacioni për stafin e KVV-ve, duke i bashkangjitur fotokopjen e letërnjoftimit dhe konfirmimin e bankës.
2. Përzgjedhja e Personelit të Tavolinave Ndhimëse, Kontrolluesve të Radhës dhe Menaxherëve të QV-ve do bëhet deri më **18.01.2021**.
3. Obligohen ZLKZ/KKZ-të që t'i dorëzojnë listat në SKQZ-së më së largu deri më **20.01.2021**.
4. Për caktimin e Menaxherëve ZLKZ-të duhet të kontaktojnë me Drejtorët e Shkollave, e në rast të mospranimit të tyre, të merren parasysh sugjerimet e tyre për persona që i preferon ai brenda shkollës, apo KKZ me vendim mund të bëjë caktimin dhe përzgjedhjen e Stafit Teknik.
5. ZLKZ/KKZ-të në secilën QV që posedon me shumë se katër (4) vendvotime duhet ta kenë edhe nga një (1) Asistent me shumë në Qendër Votimi, i cili duhet të kujdeset për respektimin dhe zbatimin e masave ndaj Pandemisë Covid-19.
6. Caktimi i numrit të stafit teknik duhet të bëhet në bazë të kësaj formule:

Numri i VV-ve në QV/ Broj BM-a u BC-u	Numri i tavolinave e ndihmëse/ Broj pomočnih stolova	Numri i personave në tavolina ndihmëse/ Broj osoblja za pomočne stolove	Numri i personave si Asistent i QV/ Broj osoblja za Asistent BC	Numri i menagjerve/ Broj menadëra	Numri i automjetave për QVV-ve/ Broj vozila za BC-e
1	1	2	1	1	1
2	1	2	1	1	1
3	1	2	2	1	1
4	1	2	2	1	2
5	1	2	2	1	2
6	1	2	3	1	2
7	2	4	3	1	3
8	2	4	4	1	3
9	2	4	4	1	3
10	2	4	4	1	4
11	2	4	5	1	4
12	2	4	5	1	4
13	3	6	5	1	5
14	3	6	5	1	5
15	3	6	5	1	5
16	3	6	6	1	6
17	3	6	6	1	6
18	3	6	6	1	6
19	3	6	7	1	7

- ZLKZ/KKZ-të për kombibusët të cilët do t'i angazhojnë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14 shkurt 2021, do të bëjnë përzgjedhjen e kombibusëve deri më 18.01.2021. Aplikacionet duhet të jenë të njëjta sikurse të personelit teknik, dhe duhet ti bashkëngjiten kopjet e Letërnjoftimit, Patentë shoferit Valid të Republikës së Kosovës, Leja e Qarkullimit dhe Polisa e Sigurimit të Automjetit. Këto dokumente duhet të jenë valide së paku deri me datë 20.02.2021.
- ZLKZ/KKZ-të së bashku me një anëtar të KKZ-së duhet të bëjnë shikimin dhe kontrollimin teknik të automjeteve dhe përshtatshmërinë e automjeteve në angazhimin e tyre për tërë procesin zgjedhor. Të bëhet përzgjedhja e kombibusëve dhe lista të dorëzohet në SKQZ deri me datë 20.01.2021.
- Formula e ndarjes së automjeteve është një automjet deri në tri (3) vendvotime, ndërsa për çdo komunë duhet të ketë edhe 10 % vetura rezerve.

- Automjetet duhet të jenë të llojit - kombi ose të ngjashme për terrene të vështira.
- Pagesat për këto kategori do të bëhen conform buxhetit të aprovuar nga KQZ dhe vendimit të KQZ-së për pagesat e Stafit Teknik dhe Kombibuseve.

Numri Vendvotimeve	Qendrat e Votimit	Vendvotimet	Asistenta	Tavolina Ndimse	Numri i automjeteve
1	303	303	303	606	303
2	267	534	267	534	267
3	119	357	238	238	119
4	66	264	132	132	132
5	51	255	102	102	102
6	24	144	72	48	48
7	17	119	51	68	51
8	13	104	52	52	39
9	9	81	36	36	27
10	3	30	40	12	12
11	4	44	20	16	16
12	4	48	20	16	16
13	3	39	15	18	15
14	3	42	15	18	15
15	1	15	5	6	6
16	2	32	12	12	12
19	2	38	14	12	14
21	2	42	16	12	14
23	1	23	8	6	8
33	1	33	8	6	11
	888				